



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 89, datë 21.05.2025

**PËR
MIRATIMIN E EMËRIMIT DHE RIEMËRIMIT TË
ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS DHE ADMINISTRATORIT TË
SHOQËRISË “ALL-SIG BROKER” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Arold Zhukri, z. Anri Sallaku dhe emërimit të zj. Enkeleda Hajderasi, si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së brokerimit “ALL-SIG BROKER” sh.a. për një mandat 3 vjeçar, deri në datë 19.04.2028.**
- 2. Miratimin e riemërimit të zj. Rezarta Zhukri si administratore e shoqërisë së brokerimit “ALL-SIG BROKER” sh.a., për një mandat 3 vjeçar, deri në datë 19.04.2028.**
- 3. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**